



Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) e Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe neni 184, paragrafi (7) të Ligjit të Shërbimeve Pagesore dhe Sistemeve Pagesore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 90/22), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

VENDIM

për përcaktimin e listës së shërbimeve më përfaqësuese në lidhje me llogarinë pagesore dhe formën dhe përmbajtjen e dokumentit informativ të kompensimeve dhe raportit mbi kompensimet dhe simbolet e tyre të përbashkëta

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përshkruhen:
 - 1) lista e shërbimeve më përfaqësuese në lidhje me llogarinë pagesore (në tekstin e mëtejme: listën e shërbimeve më përfaqësuese) me terma dhe përkufizime të standardizuara, për të cilat konsumatorët paguajnë kompensim dhe të cilat ofrohen nga të paktën një ofrues i shërbimeve pagesore në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
 - 2) formën dhe përmbajtjen e dokumentit informativ për kompensimet dhe simbolin e tij të përbashkët; dhe
 - 3) formën dhe përmbajtjen e raportit për kompensimet dhe simbolin e tij të përbashkët.
2. Ky vendim vlen për të gjithë ofruesit e shërbimeve pagesore që mundësojnë hapjen, mirëmbajtjen dhe mbylljen e llogarive pagesore të konsumatorëve.
3. Për qëllime të këtij vendimi "shërbimet më përfaqësuese" janë shërbimet që konsumatorët i përdorin më shpesh, të cilat i ekspozojnë ndaj kostos më të lartë totale ose individuale dhe që janë subjekt kompensimi i të paktën një ofruesi të shërbimit pagesor nga pika 2) e këtij vendimi.

II. LISTA E SHËRBIMEVE MË PËRFAQESUESE

4. Lista e shërbimeve më përfaqësuese përmban termat dhe përkufizimet e standardizuara të shërbimeve të mëposhtme:

	Emërtimi i shërbimit (termi)	Përkufizimi
1	Mirëmbajtja e llogarisë pagesore	Ofruesi i shërbimeve pagesore mban llogari pagesore për konsumatorin në mënyrë që të mundësojë përdorimin.
2	Përdorimi i shërbimeve onllajn që lidhen me llogari pagesore	Ofruesi i shërbimeve pagesore i mundëson konsumatorit të përdorë shërbimet që lidhen me llogarinë pagesore nëpërmjet internetit ose me aplikacion celular.
3	Transferi i kredisë në denarë në vend	Konsumatori e udhëzon ofruesin e shërbimeve pagesore që mban llogarinë e tij pagesore që të transferojë mjete për pagesë nga llogaria e tij pagesore në një llogari tjetër, në denarë.
4	Transferi i kredisë në euro jashtë vendit	Konsumatori udhëzon ofruesin e shërbimit pagesor që mban llogarinë e tij pagesore të transferojë mjete për pagesë nga llogaria e tij pagesore në interes të një llogarie tjetër jashtë vendit, në euro.
5	Transferi i kredisë në valutë të ndryshme nga euroja jashtë vendit	Konsumatori udhëzon ofruesin e shërbimit pagesor që mban llogarinë e tij pagesore të transferojë mjete për pagesë nga llogaria e tij pagesore në interes të një llogarie tjetër jashtë vendit, në valutë të ndryshme nga euro.
6	Hyrje nga jashtë	Ofruesi i shërbimit pagesor merr mjete për pagesë me transfertë krediti nga jashtë, në mënyrë që të transferojë sasinë e duhur të mjeteve për pagesë dhe t'i vërë ato në dispozicion të konsumatorit.
7	Urdhëresë e përhershme	Ofruesi i shërbimit pagesor, në pajtim me udhëzimet e konsumatorit, kryen transfertat të rregullta krediti të shumave fikse/të përcaktuara të mjeteve për pagesë nga llogaria pagesore e konsumatorit në llogari tjetër.
8	Lëshimi i kartelës së debitit	Ofruesi i shërbimit pagesor lëshon kartelë pagesore që lidhet me llogarinë pagesore të konsumatorit. Për shumën e çdo transaksioni pagesor të kryer duke përdorur kartelën e debitit,

		drejtpërdrejt dhe plotësisht zvogëlohet shuma e parave në dispozicion në llogarinë e pagesave të konsumatorit, në të cilin përfshihet mbitërheqja e lejuar.
9	Lëshimi i kartelës së kreditit.	Ofruesi i shërbimit pagesor lëshon kartelë pagesore që lidhet me llogarinë pagesore të konsumatorit. Shuma totale e transaksioneve të kryera me këtë kartelë në datën e rënë dakord debitohet tërësisht ose pjesërisht nga llogaria pagesore e konsumatorit. Ofruesi i shërbimit pagesor mund të llogarisë dhe të vendosë interes për shumën e përdorur, në pajtim me kontratën për lëshimin dhe përdorimin e kartelës së kreditit të lidhur me konsumatorin.
10	Tërheqje e parave të gatshme	Konsumatori tërheq para të gatshme nga llogaria e tij pagesore.
11	Mbitërheqja e lejuar	Bazuar në marrëveshjen e mbitërheqjes, ofruesi i shërbimit pagesor të llogarisë pagesore vë në dispozicion shumën e dakorduar të mjeteve që mund të përdoren nga konsumatori kur në llogarinë pagesore nuk ka më mjete monetare të veta. Në marrëveshjen e mbitërheqjes së lejuar përcaktohet shuma maksimale e mjeteve për pagesë që mund të huazohet nga konsumatori, si dhe kompensimet dhe interesat, nëse i paguan ofruesi i shërbimit pagesor.

5. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të përdorin termat dhe përkufizimet e standardizuara të përcaktuara nga lista e shërbimeve më përfaqësuese në pajtim me dispozitat e Ligjit të Shërbimeve Pagesore dhe Sistemeve Pagesore në:

- 1) Dokument informativ mbi kompensimet, përmbajtjen, formën dhe simbolin e tyre të përbashkët të cilat janë dhënë në shtojcën nr. 1, si pjesë përbërëse e këtij vendimi;
- 2) Raporti informativ mbi kompensimet, përmbajtjen, formën dhe simbolin e tyre të përbashkët të cilat janë dhënë në shtojcën nr. 2, si pjesë përbërëse e këtij vendimi;
- 3) Informacion për konsumatorët gjatë reklamimit / publikimit dhe para-negocimit të shërbimeve më përfaqësuese, si dhe në marrëveshjet që lidhin me konsumatorët dhe
- 4) Të dhënat për kompensimet e shërbimeve më përfaqësuese që dorëzohen në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

6. Nëse ofruesi i shërbimit pagesor, përveç termave dhe përcaktimeve të standardizuara të përcaktuara në pikën 4) të këtij vendimi, përdor edhe shpjegime shtesë për shërbimet më përfaqësuese, është i detyruar t'i japë ato konsumatorit në dokument të veçantë.

Nëse ofruesi i shërbimit pagesor lëshon dokument të veçantë në pajtim me paragrafin (1) të kësaj pike, është i detyruar që gjatë përgatitjes së atij dokumenti të ndjekë strukturën dhe rendin e listës së shërbimeve më përfaqësuese të përcaktuara në pikën 4) të këtij vendimi, dhe shpjegimet shtesë t'i formulojë në mënyrë të qartë, pa mëdyshje dhe të kuptueshme. Dokumenti duhet të jetë lehtësisht i disponueshëm për konsumatorin, qoftë në letër ose në medium tjetër të qëndrueshëm, pa pagesë dhe së bashku me listën e shërbimeve më përfaqësuese të shënuara në pikën 4) të këtij vendimi.

III. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

7. Guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut përcakton mënyrën e përgatitjes dhe plotësimit të dokumentit informativ për kompensimet, të fjalorthit dhe raportit të tarifës së kompensimit.
Udhëzimi nga paragrafi (1) i kësaj pike do të miratohet më së voni në afat prej një muaji nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë të publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe do të zbatohet nga 1 janari 2023.

V. nr. 02-15/XX-1/2022
25 nëntor, 2022
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска

Shtojca nr. 1



Dokument informativ për kompensimet

Emri i ofruesit të llogarisë pagesore:

Emri i llogarisë pagesore:

Data:

Ky dokument përmban informacion në lidhje me kompensimet e përdorimit të shërbimeve kryesore që lidhen me llogarinë pagesore. Do t'ju lejojë të krahasoni ato kosto me kostot e llogarive të tjera.

Kompensime gjithashtu mund të paguhen për përdorimin e shërbimeve që nuk janë të listuara në këtë dokument. Informacioni i plotë është në dispozicion në (fut titullin e dokumenteve përkatëse parakontraktore dhe kontraktuale).

Fjalorth i termave të përdorur në këtë dokument është i disponueshëm pa pagesë.

Shërbimi	Kompensimi
Shërbime të përgjithshme të lidhura me llogarinë	
Shërbimi kryesor (markë tregtare)	Kompensimi
Përfshin paketë të shërbimeve që përbëhet nga:	
Pagesa (përveç me kartela)	Kompensimi
Kartela dhe para të gatshme	Kompensimi
Mbitërheqje	Kompensimi
Shërbime të tjera	
Paketa të shërbimeve (markë tregtare)	Kompensimi
Shërbimet që tejkalojnë sasi të e specifikuarat faturohen veçmas	

Informacione mbi shërbimet shtesë

Informacion mbi kompensimet për shërbimet që tejkalojnë shumat e shërbimit të mbuluar nga paketa e shërbimeve (pa tarifat e deklaruar më parë)

Shërbimi	Kompensimi
(markë tregtare)	

Tregues gjithëpërfshirës i kostove



Raporti i kompensimeve

[Emri i ofruesit të llogarisë pagesore]

[Të dhënat për kontakt të ofruesit të llogarisë pagesore]

Emri i klientit

Të dhënat për kontakt

Llogaria pagesore	
Shenja e identifikimit të llogarisë pagesore	
Periudha	Nga...deri më
Data	

Ky dokument është përmbledhje e të gjitha kompensimeve të shërbimeve që lidhen me llogarinë Tuaj pagesore për kohëzgjatjen e periudhës së specifikuar.

Në analizë gjithashtu është rënditur çdo interes që keni paguar ose fituar gjatë kësaj periudhe.

Informacioni në lidhje me transaksionet individuale dhe gjendjen e llogarisë pagesore është i disponueshëm në pasqyrat e llogarisë.

Shfaqje sublimë e tarifave dhe interesit

"Gjithësej kompensime të llogaritura" (kompensime totale për shërbimet e pakosetës dhe gjithësej kompensime të llogaritura)
[.]

Gjithësej interesi i llogaritur [.]

Gjithësej interesi i fituar [.]

Tregues gjithëpërfshirës i kostove [.]

Raport i detajuar mbi kompensimin e llogaritur për shërbimet që lidhen me llogarinë pagesore

Shërbimi		Kompensimi		
Shërbimi	Sa herë është përdorur shërbimi	Çmimi për njësi	Sa herë është tarifuar shërbimi	Gjithësej
Shërbime të përgjithshme të lidhura me llogarinë				
[·]				
Përfshin paketë të shërbimeve që përbëhet nga:				
Shërbimet që tejkalojnë sasi të e specifikuar kompensohen veçmas.				[·]
Pagesa (përveç me kartela)				
				[·]
Kartela dhe para të gatshme				
				[·]
Mbitërheqje				
				[·]
Shërbime të tjera				
				[·]
Gjithësej kompensime të llogaritura				[·]

Raport i detajuar i tarifave të përfshira në paketën e shërbimit

Paketa të shërbimeve	Kompensimi	Sa herë është përdorur shërbimi
Shërbime të përgjithshme të lidhura me llogarinë pagesore		
"Shërbimet e paketës" [marka tregtare, sipas nevojës] Përfshin:	[·]	[·]
Shërbimet që tejkalojnë sasi të e specifikuar faturohen veçmas.		

Raport i detajuar mbi interesin e llogaritur për shërbimet që lidhen me llogarinë pagesore

	Norma e interesit	Interesi
		[.]
Gjithësej interesi i llogaritur		[.]

Raport i detajuar mbi interesin e fituar në llogarinë pagesore

	Norma e interesit	Interesi
"Emri i llogarisë"		[.]
Gjithësej interesi i llogaritur		[.]
Informacion shtesë		[.]